# KRIMI MJEDISOR

Krimi mjedisor është një veprimtari e paligjshme që dëmton mjedisin përmes shfrytëzimit dhe/ose shkatërrimit të burimeve natyrore, ujit, ajrit dhe tokës ose dëmtimit të zonave të mbrojtura për të nxjerrë përfitime materiale për grupe ose individë.

## SFIDAT QË PARAQET KRIMI MJEDISOR

### KËRCËNIMI PUBLIK



**26.9%** krimi mjedisor

Në vitin 2019, një studim publik i kryer nga OSBE-ja dhe Akademia e Sigurisë ku u përfshinë 1.559 të intervistuar (48.7% gra; 51.3% burra) e konsideruan krimin mjedisor si kërcënimin e dytë më të rrezikshëm për Shqipërinë

**14%** vrasjet

**39.1%** aksidentet rrugore

Në pyetjen: "Cilat janë shqetësimet tuaja kryesore sa u takon kërcënimeve ndaj sigurisë mjedisore?" 84% e të anketuarve përfshinë ndotjen e ujit, ndotjen e ajrit dhe prerjet e paligjshme ndër shqetësimet e tyre kryesore që kërcënojnë sigurinë mjedisore në Shqipëri, dhe më pas vinin ndotja e tokës (74%) dhe djegia e mbeturinave (69.2%).

- ndotja e ujit
- ndotja e ajrit
- prerje e paligjshme
- ndotja e tokës

### DËMI EKONOMIK

Krimet e mjedisit zinin vendin e katërt në nivel global në vitin 2018 sipas UNEP dhe INTERPOL.

Sipas Dokumentit të Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030 (VKM Nr. 814, datë 31.12.2018)

**1.5 MILION M³**

**dru zjarri priten çdo vit në Shqipëri, 2.5 herë më shumë se kapaciteti prodhues vjetor.**



### ZBATIMI I LIGJIT

Krimet mjedisore kërkojnë trajnim, burime dhe një **REAGIM TË SHPEJTË NGA AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT.** Shqipëria duhet të forcojë zbatimin e ligjit në lidhje me krimet e mbetjeve, krimet kundër natyrës dhe krimet mjedisore ndërkufitare.




### TË DHËNA DHE STATISTIKA

**7.69%**

Krimet mjedisore shënuan një rritje vjetore prej 7,69% në krahasim me vitin 2018, bazuar në Raportin Vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2019.

**RASTET E RAPORTUARA**
Gjatë vitit 2014-2018

- policia raportoi 1,754 raste
- prokuroria raportoi 586 raste ose 33.4% më pak

**SFIDAT KRYESORE QË PARAQESIN KRIMET MJEDISORE**

- RASTET E REGJISTRUARA SIÇ DUHET
- RASTET E GJURMUESHME
- MUNGESA E STATISTIKAVE TË PËRDITËSUARA

### BASHKËPUNIMI



Parandalimi dhe ndëshkimi i krimit mjedisor kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet:




Mësoni më shumë rreth aktiviteteve mjedisore të OSBE-së në Shqipëri:

# ARRITJET KYÇE
# NË PERIUDHËN 2015-2020



## 2015

Prodhimi i dokumentarit: 74 KM! Uji është jetë

## 2016

Ngritja e Grupit Ndërinstitucional kundër Krimit Mjedisor (GNKM) i përbërë nga 11 subjekte dhe 12 ekspertë për të shkëmbyer informacione, për të organizuar aktivitete dhe inspektime të përbashkëta dhe për të propozuar ndryshime ligjore

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për informacionin mbi mjedisin, edhe përmes artit pamor dhe veprimtarive publike

## 2017

Ndërtimi i një rrjeti të fortë kombëtar të ekspertëve dhe punonjësve nga organizata vendase, agjencitë e zbatimit të ligjit, OJQ-të dhe subjektet akademike aktive në këtë fushë

## 2018

Ofrimi i trajnimeve në nivel ekspertësh për anëtarët e GNKM-së për të zgjeruar njohuritë rreth krimit mjedisor, veçanërisht krimin e mbetjeve dhe transportin e paligjshëm ndërkufitar të mbetjeve

## 2019

Organizimi i 12 veprimtarive që lidhin pushtetin vendor, autoritetet qendrore, autoritet e zbatimit e ligjit dhe ekspertët (360 persona)

Botimi i një udhëzuesi për autoritetet lokale për masat kundër krimit mjedisor

Kontributi për ndryshimin e Kodit Penal për forcimin e dispozitave kundër krimeve mjedisore

Krijimi i Grupit Këshillimor të Organizatave të Shoqërisë Civile për të çuar përpara programin e qeverisë për krimin mjedisor

## 2020

Forcimi i lidhjeve të institucioneve akademike me institucionet dhe zinxhirin zbatues

Botimi i dy publikimeve "Krimi Mjedisor, Siguria Mjedisore dhe Siguria Kombëtare", rezultat i Konferencës V Shkencore Ndërkombëtare

# VEPRIMTARITË DHE AFATET E ARRITJEVE
# TË PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

### Vlerësimi

Në vitin 2015, Prezenca realizoi një vlerësim institucional dhe analizë SWOT të situatës së krimit mjedisor në Shqipëri

Më pas u hartua dhe u vu në zbatim një urdhër ministror për krijimin e një Grupi Ndërinstitucional Kundër Krimeve Mjedisore (GNKM) ku përfshihen:

- Policia
- Qendra Ndërinstitucionale e Operacioneve Detare
- Inspektorati i Mjedisit
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Inspektorati i Tokave
- Tatimet
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
- Doganat
- Policia Rrugore
- Prokuroria
- Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura

### Bashkëpunimi

Në vitin 2016, Prezenca hartoi një strategji dhe një Plan për Zhvillimin Institucional 2015-2020 për GNKM-në

Në 2017, u sigurua trajnimi dhe zhvillimi profesional për të gjithë anëtarët e GNKM-së, gjë që çoi në akreditimin e 12 anëtarëve të grupit (nga Autoriteti Skocez i Kualifikimit)

### Funksionaliteti

Nga viti 2018-2020, puna iu kushtua forcimit të ndërveprimit të grupit, inspektimeve të përbashkëta dhe bashkëpunimit përmes vizitave në terren, prezantimeve institucionale, seminareve, forumeve dhe diskutimeve publike, si dhe ligjëratave në universitetet publike

Mësoni më shumë rreth aktiviteteve mjedisore të OSBE-së në Shqipëri:

# LEGJISLACIONI PËR KRIMIN MJEDISOR

LEGJISLACIONI PËR KRIMIN MJEDISOR NË SHQIPËRI

Dënimi




Kodi Penal i Shqipërisë, i ndryshuar në tetor 2019

# RËNDËSIA QË KA RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT PËR KRIMIN MJEDISOR

**Qytetarët** – Qytetarët duhet të informohen për krimet mjedisore, rreziqet dhe dëmtimet që vijnë prej tyre. Ata duhet të mësojnë dhe të angazhohen për të parandaluar krimet mjedisore në territorin e tyre.

**Media** – Ne jetojmë në kohën e medias digjitale dhe informacionit të hapur. Përdorimi i mediave për të komunikuar, për t'u lidhur me njerëzit dhe për të nxitur reagimin e tyre është shumë i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit dhe nxjerrjen në dritë të krimeve mjedisore.

**OSHC-të** – Shoqëria civile punon për probleme të ndryshme që lidhen me mjedisin, siç janë ndotja industriale, degradimi i mjedisit, shkelja e legjislacionit dhe praktikat korruptive. Si të tilla, OSHC-të duhet të bashkojnë forcat dhe të ngrenë shqetësimet e tyre si dhe t'u ofrojnë institucioneve zgjidhje për trajtimin e krimeve mjedisore.

**Qeveria** – Qeveria duhet të bashkëpunojë dhe të përdorë ekspertizën e të gjithë palëve të interesuara me qëllim të shkurajimit, parandalimit dhe ndjekjes penale të krimeve mjedisore në Shqipëri.

Mësoni më shumë rreth aktiviteteve mjedisore të OSBE-së në Shqipëri:


OSCE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**Prezenca në Shqipëri**

Ndiqni Prezencën e OSBE-së në Shqipëri